

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7874  
E shtunë, 31 gusht 2024  
Çmimi 0.50

## Lajçaku: Shoqëritë në Kosovë dhe në Serbi nuk janë gati për normalizim

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KOSOVA KUJTON TË ZHDUKURIT ME DHUNË GJATË LUFTËS: SERBISË T'I BËHET TRYSNI

FAQE 4-5



Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, kryeministri Albin Kurti bashkë me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla

dhe me nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, përfaqësues të organizatave të familjarëve të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë, ambasadorë dhe diplomatë të

tjerë të akredituar në vendin tonë, kanë bërë homazhe të premtën të lapidari kushtuar më të dashurve tanë, për fatin dhe vendndodhjen e të cilëve nuk dimë ende asgjë as pas 25 viteve

## KOSOVA DHE SHOIPËRIA FOKUSOHEN NË RRRITJEN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

F.3



## SARRAZIN: NEVOJITEN KOMPROMISE TË VËSHITURA NGA KOSOVA DHE SERBIA DREJT BE-së

F.7



## AKTUALE



## BORRELLI KËRKON QË UKRAINËS T'I HIQEN KUFIZIMET PËR PËRDORIMIN E ARMËVE

F.2

## TUROIA ARRESTOI MBI 100 ANËTARË TË DYSHUAR TË IS-it

F.2

## SIGURIMI PUBLIK SHËNDETËSOR: PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

F.5

## EKONOMI



## ÇMIMET E IMPORTIT, MË TË LARTA NË TREMUJORIN E DYTË 2024 SESA NË ATË TË 2023-s

F.8

## MURATI DHE AMBASADORI I BRITANISË DISKUTOJNË PËR INVESTIMET NË KOSOVË

F.8

## SPORT



## ADEMI: FJALËT E TRAJNERIT TË LEGIAS NUK QËNDROJNË, FUSHA ËSHTË NË GJENDJE SHUMË TË MIRË

F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Borrelli kërkon që Ukrainës t'i hiqen kufizimet në përdorimin e armëve

**BRUKSEL, 30 GUSHT** - Shefi i politikës së jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, u ka bërë thirrje aleatëve perëndimorë të Ukrainës që t'i heqin kufizimet për përdorimin e armëve, duke thënë se Kievi ka të drejtë t'i sulmojë vendet nga të cilat sulmohet. Duke folur në Bruksel, përpara një takimi jozyrtar të ministrave të Mbrojtjes të BE-së, Borrelli tha se është "absurde" të thuash se sulmet në territorin e Rusisë do të nënkuptonin luftë direkte kundër Moskës. "Askush nuk dëshiron një luftë me Rusinë, por vendoseni veten në vendin e ukrainasve: Rusët po ju bombardojnë nga një vend ku nuk mund të arrini. Ju

dëshironi të luftoni si të barabartë", tha ai, duke shtuar se për ta bërë këtë, Ukraina duhet të jetë në gjendje t'i godasë vendet nga ku Rusia e sulmon. Zyrtarët ukrainas, përfshirë presidentin Volodymyr Zelensky, u kanë bërë vazhdimisht thirrje aleatëve globalë të Ukrainës që ta lejojnë atë t'i godasë objektivat ushtarake më thellë brenda Rusisë me armët që ia siguron Perëndimi. Javë më parë Ukraina ka nisur një inkursion në territorin rus. Zelensky ka thënë se Rusia "duhet ta ndiejë atë që ka bërë". Ditët e fundit Rusia është përgjigjur me sulme të ashpra me raketa dhe dronë, të cilat kanë

pasur në shënjestër infrastrukturën civile në të gjithë Ukrainën. Zyrtarët ukrainas thonë se, pavarësisht prej dërgesave të armëve të reja që po e ndihmojnë Ukrainën, forcat e saj të armatosura janë ende në disavantazh, sepse kufizimet e Perëndimit i pengojnë ato që t'i përdorin armët me rreze të gjatë, për të goditur thellë brenda territorit rus. "Siguria afatgjatë për Evropën fillon me vendime afatshkurtra dhe të guximshme për Ukrainën", u tha ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, gazetarëve në Bruksel më 29 gusht.



## Turqia arrestoi mbi 100 anëtarë të dyshuar të IS-it



**ANKARA, 30 GUSHT** - Turqia arrestoi këtë javë mbi 100 anëtarë të dyshuar të grupit militant, Shteti Islamik (IS), njoftuan autoritetet të premtën. Ky vend është goditur nga disa sulme të mëdha - përfshirë një në një klub nate në vitin 2017, kur janë vrarë dhjetëra njerëz - përgjegjës për të cilat e ka marrë Shteti Islamik. Bastisjet e fundit u bënë në të gjithë Turqinë, përfshirë kryeqytetin Ankara dhe qytetin më të madh, Stambollin, shkroi ministri i Brendshëm turk, Ali Yerlikaya, në platformën sociale X. Arrestimi i 119 personave këtë javë pason ndalimin e 99 të të

dyshuarve të tjerë në fillim të gushtit. Që nga rënia e "kalifatit" të vetëshpallur të Shtetit Islamik në vitin 2019, disa anëtarë të dyshuar të këtij grupi nga Siria dhe Iraku janë vendosur në Turqi. Autoritetet turke kanë thënë se që nga qershori i vitit 2023 janë arrestuar më shumë se 3 600 persona për lidhje të dyshuara me grupin xhihadist. Dy nga sulmuesit që kanë vrarë 145 njerëz në një sallë koncertesh në Moskë në muajin mars, kanë kaluar disa javë në Turqi përpara se të shkonin në Rusi, sipas autoriteteve lokale. Përgjegjës për këtë sulm e ka marrë Shteti Islamik.

## Gjermania dëbon dhjetëra afganë në Afganistan

**BERLIN, 30 GUSHT** - Gjermania dëboi disa afganë në vendin e tyre - për herë të parë prej se talibanët morën pushtetin në Afganistan në gusht të vitit 2021. "Ata ishin të gjithë të dënuar, të cilët nuk kishin të drejtë të qëndronin në Gjermani dhe kundër të cilëve ishin lëshuar urdhra për dëbim", tha zëdhënësi i Qeverisë gjermane, Steffen Hebestreit. Agjencia e lajmeve, DPA, raportoi se një avion i kompanisë Qatar Airways me 28 shtetas afganë në

bord, të cilët kishin arritur në Gjermani nga shtete të ndryshme, është nisur nga Lajpcihu për në Kabul mëngjesin e së premtes. Operacioni u organizua nga Ministria e Brendshme e Gjermanisë. Gjermania nuk ka marrëdhënie diplomatike me udhëheqësit talibanë në Kabul. Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë pas një sulmi vdekjeprurës me thikë në qytetin Manhajm në

fund të majit, se dëbimi i kriminelëve të rrezikshëm dhe i të dyshuarve terroristë në Afganistan dhe Siri do të bëhet i mundur. Debati është rikthyer pas një sulmi vdekjeprurës me thikë javën e kaluar në qytetin e Solingenit, ku kanë mbetur të vdekur tre persona. I dyshuari kryesor për këtë sulm është një 26-vjeçar sirian, i cili besohet se i ka shpëtuar urdhrin të dëbimit.



## Nga rrëshqitja e dheut në Pakistan vdesin 12 veta, shumica fëmijë

Islamabad, 30 gusht - Një rrëshqitje dheu, e shkaktuar nga shirat monsun, goditi një shtëpi në veriperëndim të Pakistanit, duke shkaktuar vdekjen e 12 personave. Shumica e viktimave janë

fëmijë, tha një zyrtar i ekipeve të shpëtimit. Shërbimi i Emergjencave tha se incidenti ka ndodhur gjatë natës në provincën Khiber Paktunkva. Sipas tij, ekipet e shpëtimit kanë arritur të

nxjerrin trupat e pajetë të nëntë fëmijëve, dy grave dhe një burri. Autoritetet kanë paralajmëruar se shirat e furishëm, që kanë nisur muajin e kaluar, mund të

shkaktojnë rrëshqitje dheu dhe përmytje në Pakistan. Që nga 1 korriku mbi 275 njerëz kanë vdekur në incidente të lidhura me shirat në pjesë të ndryshme të këtij vendi.



## Lajçaku: Shoqëritë në Kosovë dhe në Serbi nuk janë gati për normalizim

Prishtinë, 30 gusht - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë se ekziston rreziku për destabilizim të Ballkanit Perëndimor nëse palët nuk angazhohen në dialog dhe vazhdojnë të bëjnë veprime të pakoordinuara e të ngutshme. Në intervistën për Radion Evropa e Lirë, në margjina të forumit GLOBSEC, që po

mbahet në Pragë, Lajçaku e ka pranuar se nuk është bërë mjaftueshëm për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit të arritur mes palëve vitin e kaluar, por marrëveshje më e mirë nuk mund të arrihet dhe se palët duhet ta kuptojnë që përparimi në dialog është thellësisht i lidhur me rrugën e tyre drejt BE-së. "Nëse më pyesni mua, problemi është se dy shoqëritë [në Kosovë

dhe në Serbi] nuk janë gati për normalizim", ka theksuar ai.

I pyetur se si duhet të përfundojë dialogu, edhe nëse duhet të përfshihet njohja reciproke, ai ka thënë se u takon palëve të vendosin në atë aspekt. Ai ka folur edhe për sulmin në Banjškë dhe akuzat që i janë bërë nga zyrtarë të Kosovës për qasje të padrejtë ndaj vendit.



## Kosova dhe Shqipëria fokusohen në rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të premten me ceremoni të lartë ushtarake ministrin e ri të Mbrojtjes së Shqipërisë, Pirro Vengu, i shoqëruar nga delegacioni i tij. Pas takimit të dy ministrave, u zhvillua edhe takimi dypalësh në mes të delegacioneve, ku u diskutua për bashkëpunimin e ngushtë e vëllazëror, si dhe zgjerimin e tij, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në konferencën për medie, organizuar me rastin e kësaj vizite,

ministri Maqedonci falënderoi homologun për nderin dhe respektin e treguar me rastin e zhvillimit të vizitës së parë jashtë vendit në Republikën e Kosovës. "Me Republikën e Shqipërisë dhe me Ushtrinë shqiptare bashkëpunojmë në vazhdimësi për t'u përballur me çdo sfidë, rrezik dhe kërcënim, që synon ta kërcënojë trashëgiminë, vlerat dhe sigurinë tonë të përbashkët. Me mbështetjen e Republikës së Shqipërisë synojmë që në të ardhmen të jemi pjesë e strukturave të tjera euroatlantike", tha ministri Maqedonci, duke shtuar se si dy vende demokratike do të vazhdojnë të kontribuojnë

në luftën globale kundër rreziqeve që kërcënojnë sigurinë globale. Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, falënderoi ministrin Maqedonci për pritjen e ngrohtë e vëllazërore dhe theksoi se Ministria e Mbrojtjes dhe FARSH, me të gjitha mundësitë që kanë, do ta mbështesin FSK-në për rritjen e kapaciteteve si dhe investimin në kapital njerëzor. Të dy ministrat e mbrojtjes theksuan se bashkëpunimi i shkëlqyer në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në mes të të dy vendeve do të vazhdojë të thellohet edhe më tutje, sidomos në fushën e trajnimeve dhe operacionalitetit, me theks të

veçantë në zgjerimin e bashkëpunimit në industrinë ushtarake. Edhe kryeministri Albin Kurti mirëpriti në ndërtesën e qeverisë ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë, Pirro Vengu. Fillimisht shprehu kryeministri shprehur falënderimin për mbështetjen e Shqipërisë dhe raportet vëllazërore. Vuri theksin veçanërisht edhe në thellimin e bashkëpunimit në mes të ministrave tona të mbrojtjes. Nga marrëveshjet e arritura si ajo për lehtësimin e procedurave të kalimit tranzit të mallrave ushtarake për qëllime dhe nevoja të dyanshme dhe marrëveshja

mbi fushën e mjekësisë ushtarake, deri te rëndësia e aspektit të trajnimeve, ushtrimeve të përbashkëta, bashkëpunimit në misionet paqeruajtëse dhe operacione ndërkombëtare si pjesë e një kontingjenti dhe investimet e përbashkëta në industrinë e mbrojtjes. Kryeministri Kurti nënvizoi mbështetjen e Shqipërisë edhe për anëtarësimin e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në Kartën e Adriatikut (A-5), ku Shqipëria është edhe kryesuese këtë vit. Duke falënderuar për vizitën dhe bashkëpunimin, kryeministri i uroi qëndrim të frytshëm në Kosovë ministrit Vengu.


## Osmani përfaqëson Republikën e Kosovës në GLOBSEC në Pragë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Pragë të Republikës Çeke, për të marrë pjesë në forumin

global të sigurisë GLOBSEC 2024. Presidentja Osmani do të jetë në mesin e liderëve globalë të cilët do të mblidhen në Pragë me qëllim të diskutimit të

sfidave të ndryshme gjeopolitike dhe rëndësisë së bashkëpunimit për tejkalimin e tyre. Presidentja Osmani do t'i drejtohet audiencës

ndërkombëtare në një diskutim mbi perspektivën e Kosovës karshi zhvillimeve gjeopolitike, gjersa do të realizojë edhe takime të tjera bilaterale.





# Kosova kujton të zhdukurit me dhunë gjatë luftës: Serbisë t'i bëhet trysni

Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, kryeministri Albin Kurti bashkë me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla dhe me nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, përfaqësues të organizatave të familjarëve të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë, ambasadorë dhe diplomatë të tjerë të akredituar në vendin tonë, kanë bërë homazhe të premtën të lapidari kushtuar më të dashurvet tanë për fatin dhe vendndodhjen e të cilëve nuk dimë ende asgjë as pas 25 viteve

dispozicion të gjitha dokumentet me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur.

Deri më tash këto zotime kanë mbetur vetëm në letër.

Autoritetet në Serbi, ngjashëm, kanë fajësuar Kosovën për angazhim jo të duhur.

Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, në përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës janë bërë homazhe të përmendorja dedikuar personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës pranë Kuvendit të Kosovës.

Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministrja Donika Gërvalla, nënkryetaria e Kuvendit, Saranda Bogujevci, përfaqësues të organizatave të familjarëve të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe me ambasadorë dhe diplomatë të tjerë të akredituar në vendin tonë, pasi vendosi lule të freskëta dhe bëri homazhe, tha se ende pas 25 vjetëve nuk dihet për fatin e 1 595 personave. "Shumica

apo afër 94 për qind të atyre që u zhvarrosën dhe u kthyen si kufoma në vendlindje, kjo ndodhi në muajt e fundit të vitit 2000 dhe përgjatë vitit 2001, pra pas rrëzimit të Millosheviqit në Serbi, në varrezat masive në Batajnicë, Petrovo Selo dhe Peruçac. Në këto tri varreza masive gjithsej janë nxjerr 900 shqiptarë, pleq, gra, fëmijë, 900 gjithsej. 744 në Batajnicë dhe 84 dhe 72 në Petrovo Selo edhe në Peruçac. Pastaj nuk ka pasur zhvarrime të tjera, sepse nuk ka pasur gjurmime dhe, në periudhën nga viti 2010 deri në 2021, në dy varreza të tjera masive janë nxjerrë edhe 61 shqiptarë të tjerë, 54 në Rudnicë edhe 7 në Kizhevack.

Pra, pjesa më e madhe, afër 94 për qind të zhvarrosurve janë në muajt e parë pas rrëzimit të Millosheviqit dhe më pastaj nuk ka pasur vullnet në Serbi për gjurmime të mëtejshme. Në Kosovë i kemi 2800 gjurmime në këto 25 vjetë liri, ndërkaq në Serbi janë vetëm këto pesë varreza masive", u shpreh kryeministri. Si rezultat i punës dhe angazhimit të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, në krye të të cilit ndodhet Andin Hoti, por edhe

angazhimit të organizatave e shoqatave të familjarëve, kanë filluar gjurmimet në Kozhlye, i cili është një vend në Serbi, në Sanxhak, midis Tutinit dhe Novi Pazarit.

Kryeministri Kurti u bëri thirrje edhe njëherë faktorëve ndërkombëtarë që ashtu qysh na kanë ndihmuar me trysni mbi Serbinë që të fillojë gjurmimi atje, të bëjnë trysni mbi Beogradin që të hapet arkiva e Brigadës së motorizuar 37 të ushtrisë jugosllave, aty ku edhe është e vërteta. "Ne po kërkojmë jo hapjen e arkivave thjesht në përgjithësi, atë doemos, mirëpo po kërkojmë edhe hapjen e një arkivi fort specifik. Është arkivi i Brigadës 37 të motorizuar të ushtrisë jugosllave", tha kryeministri.

Kurti tha se kurrë nuk kanë qenë prioritet më i lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës sesa tani gjurmimet vlerësuese, gjurmimet në përgjithësi, trysnia mbi Beogradin dhe bashkëpunimi me faktorët ndërkombëtarë, aleatët e partnerët tanë të cilët i falënderoi për angazhimin e tyre.

Në ditë më parë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve me Forcë kanë reaguuar përfaqësues të institucioneve të vendit dhe liderë partish.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se mbi 1 600 personat e zhdukur nga lufta e viteve 1998/99 në Kosovë mbeten "plaga më e thellë" e vendit. Përmes një postimi në "Facebook", ajo tha se "Serbia po e përsërit krimin" duke "e mohuar të vërtetën" dhe se po shkel

marrëveshjet e arritura duke mos i hapur arkivat. "E vërteta nuk mund të fshihet prapa propagandës se kinse Serbia qenka pro paqes dhe pro integritimit në BE. E vërteta është një dhe e vetme: në vitin 2024 Serbia ende fle mbi varreza masive të civilëve të pafajshëm", ka shkruar Osmani në "Facebook" në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve me Forcë. Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia përmes Deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur janë zotuar se do të ofrojnë qasje të plotë në informacione të besueshme dhe se do t'i vënë në

# Sigurimi publik shëndetësor: Pse është i rëndësishëm?

PRISHTINË, 30 GUSHT - Funkcionalizimi i sistemit të sigurimit publik shëndetësor ka qenë vetëm një prej 42 zotimeve që ka bërë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fushatën e zgjedhjeve të vitit 2021. Ligji ekzistues për sigurimin shëndetësor, i miratuar më 2014, nuk është zbatuar kurrë. Arsyetimi kryesor: implikimet financiare.

Më 28 gusht 2024 Qeveria e miratoi Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Qytetarët e Kosovës janë të vetmit në rajonin e Ballkanit Perëndimor që vuajnë mungesën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor. Përveç në aspekt të cilësisë së shërbimeve, ata dëmtohen edhe nga ana financiare e psikologjike. Kur një qytetar i Kosovës sëmurët, përveç shqetësimit shëndetësor, atij i shtohet edhe ngarkesa se sa do t'i kushtojë trajtimi.

Mungesa e sigurimit të detyrueshëm publik shëndetësor besohet se i ka dëmtuar të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos shtresat e varfra të shoqërisë dhe grupet e cënueshme - pensionistët dhe rastet sociale.

Besim Kodra nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë tregon për Radion Evropa e Lirë se 20 për qind e qytetarëve të Kosovës nuk marrin shërbime shëndetësore në mungesë të mjeteve financiare. Ai thotë se këta qytetarë "po vdesin në dhimbje".

Ndërkaq, profesori për politika dhe sistem shëndetësor të Kosovës, Liridon Bllaca, përmend për Radion Evropa e Lirë tri arsye pse sigurimi publik shëndetësor është i rëndësishëm: Mbron prej rreziqeve financiare duke mbuluar kostot kur kërkohet

trajtim mjekësor; Lehtëson qasjen në shërbime shëndetësore, mundëson kontrolle rutinë dhe, kështu, ndikon në parandalimin e sëmundjeve të dhimbshme e të kushtueshme; Ofron mirëqenie mendore, duke reduktuar stresin në rast të një nevojë urgjente, sepse ekziston një lloj sigurie.

## A është sigurimi shëndetësor barrë për qytetarët dhe punëdhënësit?

Për Bllacën kjo gjë as nuk do të duhej të diskutohej pasi që, sipas tij, ky sistem duhet të shihet si investim në shëndet. Ai nuk pajtohet me pohimin e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se sigurimi shëndetësor nuk nënkupton që qytetarët do të paguajnë më pak për shërbime shëndetësore. Sipas Bllacës, "qytetarët paguajnë shumë për shërbime shëndetësore. Qytetarët marrin shërbime esenciale, prandaj për kryeministrin kjo shumë mund të jetë e vogël. Në një qendër të mjekësisë familjare në Prishtinë pacienti merr shërbim dhe paguan 1 euro, por për një rezonancë magnetike duhet pritur shumë, e për ta kryer në sektorin privat duhet të paguash 100-150 euro. Kjo është shumë e madhe për ekonomitë familjare".

Edhe Kodra beson se shëndetësia nuk është e lirë për xhepin e qytetarëve, sidomos për grupet e cënueshme. "Mbi 50 për qind e popullsisë blen ilaçe, shërbimi spitalor shfrytëzohet nën 50 për qind, dhe këto tregojnë më se miri se njerëzit paguajnë shumën e majme parash për t'u trajtuar në spitale private ose jashtë shtetit".



Mungesa e sigurimit është përmendur edhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2023, meqë është vlerësuar që "pabarazitë në shëndetësi mbeten një problem serioz" në këtë vend dhe që mungesa e sigurimit po i kushton shumë xhepit të qytetarit.

Në Kosovë ekzistojnë disa kompani private që ofrojnë sigurim shëndetësor, mirëpo nuk dihet se sa qytetarë e shfrytëzojnë këtë mundësi.

## Çfarë përfshin sigurimi publik shëndetësor?

Kur të zbatohet, projektligji parasheh që kontributi mujor për një person të jetë 7 për qind e të hyrave - 3.5 për qind të paguajë punëdhënësi dhe 3.5 për qind punëtori. Kjo nënkupton që një pacient më pas nuk do të duhet të paguajë për trajtim dhe ilaçe kur të ketë nevojë.

Kodra sqaron se pensionistët dhe rastet sociale do të lirohen nga pagesa, ndërsa për personat e

papunë, kryefamiljari do të duhet të paguajë nga 2 euro shtesë. Sipas Bllacës dhe Kodrës, thelbësor për sigurimin publik shëndetësor është krijimi i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh), licencimi i institucioneve shëndetësore publike dhe hartimi i listës dhe i çmimoreve të shërbimeve shëndetësore.

Një Sistem i mirëfilltë Informativ Shëndetësor, mes të tjerash, do t'i mundësonte personelit mjekësor ta kishte historikun e komplikimeve të kaluara shëndetësore të pacientit, dhe kështu do të mund të rritej cilësia e trajtimit të tij.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, u ka thënë medieve se Kosova ka nënshkruar një marrëveshje me Bankën Botërore për financimin e planit të veprimit për SISh-in, por se miratimi i tij tani i takon Kuvendit të Kosovës.

Shumë e rëndësishme konsiderohet edhe përfshirja e institucioneve private në listën e ofruesve të shërbimeve. Në rast të një komplikimi që nuk mund të trajtohet në Kosovë, sigurimi do të

duhej të mundësonte organizimin e trajtimit jashtë vendit.

## Kur mund të nisë zbatimi?

Përveç procedurave për miratim në Kuvend, Kodra beson se ka edhe shumë ndërlikime të tjera që do ta pamundësojnë zbatimin e ligjit brenda pesë viteve të ardhshme.

Çështja e sigurimit publik shëndetësor është zvarritur nga qeveria në qeveri.

Më 2017 qeveria e atëhershme pati ndarë 17 milionë euro për fondin e sigurimit, por më vonë i kishte tërhequr ato, për t'i orientuar për pensione të veteranëve të luftës. Buxheti për sistemin e përgjithshëm shëndetësor për vitin 2024 kap vlerën e 345 milionë eurove. Mbetet të shihet nëse ky buxhet do të rritet në të ardhmen për ta mundësuar zbatimin e ligjit.

## A do ta rrisë sigurimi cilësinë e shërbimeve?

Po. Kodra beson se kjo mund të arrihet për shkak të ndryshimit të mënyrës së financimit. "Stafi shëndetësor nuk do të paguhej më në bazë të kualifikimeve, por në bazë të një performancë që ofron për shërbimin shëndetësor, dhe ajo do t'i kënaqte më shumë edhe nevojat e personelit shëndetësor, edhe nevojat e pacientëve, sepse do të rritej përkushtimi i personelit ndaj pacientëve, dhe kështu do të avancohej sistemi shëndetësor". Ai thotë se institucionet shëndetësore nuk janë shumë llogaridhënëse aktualisht vetëm për shkak se nuk paguhet në bazë të performancës.



qeveria e tij është e përkushtuar për trajtimin e secilës informatë që kontribuon në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur. Po ashtu, ai ka bërë me dije se kanë filluar përgatitjet për gërmime në lokacionin Kozhle në Serbi në kërkim të personave të zhdukur.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Përgjatë viteve, mijëra trupa janë gjetur në lokacione të ndryshme por, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, në Kosovë vazhdojnë të jenë të pagjetur edhe 1 612 persona -

pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka vizituar ekspozitën 'Na ishte një herë që kurrë mos qoftë' në Qendrën e Dokumentimit Kosovë. Aty u pritë nga drejtori i Fondit për të Drejtën

Humanitare Kosovë, Bekim Blakaj dhe kuratorja Blerta Hoçia. "Kjo dhimbje vazhdon dhe sot, kur mbi 1 600 kosovarë vazhdojnë të mbesin të zhdukur një çerek shekulli pas përfundimit të luftës", ka thënë Abdixhiku.

Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se

kjo plagë e hapur kërkon vëmendje urgjente, andaj shteti ynë duhet t'i shtojë përpjekjet për zbardhjen e fatit të tyre. "Në këtë drejtim ne do të punojmë pa pushim për drejtësi, duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë", ka thënë Haradinaj.



# Jahja Fusha, Shaban Shala, Xheladin Rekaliu dhe Bajrush Behrami - katër asetët e shqiptarisë në Ilap



**Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA**

Vlerat dhe veprat që nuk i nënshtrohen asnjë ndryshku: Sot, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës, Mal të Zi dhe trevat ku jetojnë shqiptarët kemi probleme të theksuara me identitetin kombëtar. Në këtë gjysmëliri, vlerat e mirëfillta kombëtare janë marginalizuar, i janë nënshtuar harresës së imponuar nga politikanët pa kurriz kombëtar, me integritet të turbullt njerëzor dhe moral, me një të kaluar qartazi në kundërshtim me kombin që i takojnë, me një ndërgjegje dhe vetëdije të robit nga e kaluara, konformistë, manipulues, mashtrues dhe tregtarë flamujsh dhe të politikave. Për fatin e keq, ky farë soj sorrollapi është në pushtet, kryesisht. Prandaj vlerat kombëtare janë hedhur në fund të pusit kurse, mbi sipërfaqe ka zënë vend ndryshku nga e kaluara jugosllave dhe serbe. Si askund në botë, në Kosovë po imponohet një karikaturë “kombëtare” politike, populli kosovar, si dikur populli jugosllav. Si asnjëherë më parë, besimi apo feja po imponohen si kriter përcaktues të patriotizmit të dikujt apo mungesë të atdhedashurisë të tjetërkujt. Kosova është një vend i vogël, me tendencë të bëhet edhe më e vogël. Realisht, hapësira ku jetojnë shqiptarët është tkurrur shumë krahasuar me më parë. Edhe këto hapësira janë mbrojtur me shumë vuajtje, djersë, burgosje, tortura e deri me humbje jete. Kapaku i këtyre ishte lufta e lavdishme e së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës në krye Komandantin Politik, Abetaren dhe Kuptimin e Luftës për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, Bacën Adem Demaçi dhe Komandantin Usharak, Legjendarin Adem Jashari. Çdo kohë dhe çdo rajon i Kosovës dhe tokave shqiptare i ka heronjtë e vet

që i kanë mbijetuar të gjitha kohëve për shkak të veprave që i bënë dhe i kanë lënë si trashëgimi dhe udhërrëfyes në rrugën e gjatë drejt lirisë dhe bashkimit kombëtar. Liria dhe bashkimi kombëtar nuk janë vlera lokale apo rajonale por kanë shtrirje dhe karakter të përgjithshëm, universal apo planetar. Ndonëse kam lindur dhe rininë e hershme e kam kaluar në Llap (Kunushec dhe Besianë), familja ime prejardhjen e ka nga Shala e Bajgorës përkatësisht nga fshati Kovaçicë. Duket se rrjedhim nga familja Istrefi. Përkundër kësaj, formësimin kombëtar dhe politik e kam nga Llapi përkatësisht nga Podujeva duke jetuar në një rreth me 99 për qind serbë ndërsa familja e Shaban Shalës - Bajgorës ishte e vetmja familje shqiptare në qendër të Besianës. E kishim shtëpinë përballë burgut ku çdo natë dëgjoheshin klithmat dhe bërtitmat e shqiptarëve të burgosur, qoftë në aksionin e grumbullimit të armëve, qoftë për shkak të aktivitetit politik dhe kombëtar. Ishte koha e kriminelëve Josip Broz Tito dhe Aleksandar Ranković. Si fëmijë dëgjonim për Adem Demaçin duke mos ditur se kush ishte ky. Besiana dhe Llapi kanë dhënë shumë patriotë dhe heronj të kombit, që e nderuan atdheun dhe kombin duke u shndërruar në yje të pashuara në qiellin ku liria ishte e pakufishme dhe e pakushtëzuar. Pas një rrugëtimi 70-vjeçar, nga e tëra kjo galaktikë e yjeve të lirisë, unë i dalloj katër yje që për aq kohë sa do të jetojë shqiptaria, asnjëherë nuk do të shuhet. Për dy prej tyre vetëm kam dëgjuar dhe kam lexuar ndërsa me dy të tjerë kisha nderin t'i njoh, si shokë, miq dhe bashkëveprimtarë. Po kush ishin asetët e shqiptarisë në Llap?

**1. JAHJA FUSHA:** Një intelektual me një shkollim dhe edukatë të veçantë, politikan i zoti,

ushtarak dhe strateg i jashtëzakonshëm, aspak hezitues për sakrificim të jetës për atdhe dhe komb, sportist dhe bukurosh, aristokrat me prejardhje dhe me sjellje, pishtar i fushalinjve dhe ndriçues i rrugës së shqiptarëve drejt lirisë dhe bashkimit kombëtar. I djathtë politikisht dhe 100 për qind i përcaktuar kombëtarisht. I lindur në janar të vitit 1919 dhe i rënë në altarin e lirisë në janar të vitit 1944. 25 vjet jetë të shndërruara në 250 milionë vjet të vlerave kombëtare. Si 24-vjeçar mori pjesë në Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, si delegat i Llapit duke mbrojtur qëndrimin që Llapi, Mitrovica, Vushtrria, Sjenica dhe Pazari i Ri t'i bashkohet Shqipërisë etnike. Pati rastin të largohet nga Kosova, bashkë me patriotin Emrush Miftari por qëndruan në mbrojtje të atdheut dhe kombit, deri në rënien heroike. Partizanët jugosllavë dhe shqiptarë ua zhdukën edhe eshtrat duke mos e lënë edhe një copë toke shqiptare për pelegrinazh për gjeneratat e ardhshme. Tash, e tërë toka ka jetojnë shqiptarët u shndërrua në vend prehje për Kolosin e çështjes Kombëtare, të pavdekshmin dhe të gjithëmonshmin, JAHJA FUSHA.

**2. SHABAN SHALA:** I lindur në vitin 1933 në Letan të Besianës dhe i mbytur nën torturë në vitin 1963 në Burgun e Prishtinës, Bastijën ku ekzekutoheshin patriotët shqiptarë nga udbashët serbë, jugosllavë dhe shqipfolës. Si i ri ishte angazhuar në NDSH, lëvizjen më patriotike të shqiptarët që në asnjë mënyrë nuk e pranonin komunizmin, Jugosllavinë dhe Serbinë duke e kundërshtuar me armë në duar e që plumbin e fundit në mbrojtje të këtij ideali e kishin jetën e tyre. Moto e tyre ishte një komb, një gjuhë dhe një atdhe. Kombi ishte shqiptar, gjuha ishte shqipe kurse atdheu ishte Shqipëria. Në mbrojtje të këtij

ideali, Shaban Shala e dha jetën nën tortura më të tmerrshme. Në prag të vdekjes, Shaban Shala këndonte: “O ku vend nuk është as Serbi e as Jugosllavi por është Kosovë dhe Shqipëri...” Me bindje politike ishte Jahja Fushën. Në këshjellën e shqiptarëve për liri dhe bashkim kombëtar, Shaban Shala e vuri në themel një gur që i mbijeton të gjitha kohët, jetën e tij.

**3. XHELADIN REKALIU:** Ishte nga brezi i artë i patriotëve shqiptarë që e bartën flakadanin e lirisë që nga rilindësit, nacionalistët shqiptarë pas luftës së dytë botëror për t'ua dorëzuar gjeneratave që kulmuan me luftën çlirimtare të UÇK-së. Si organizator i demonstratave të vitit 1968 u dënua me katër vite burg të rëndë në Goli Otok, vendferr për të dënuarit politikë që e kundërshtonin Jugosllavinë dhe Serbinë. Xheladin Rekaliu ishte në xherdanin e margaritarëve kombëtarë bashkë me Skender Kastratin, Rexhep Malën, Hamit Abdullahun, Hakif Shehollin, Ibrahim Demollin dhe patriotë të tjerë që nuk e ndali aktivitetin deri në kohën kur u nda nga jeta në vitin 1998 ndërsa kishte lindur në vitin 1948. Guru politik dhe kombëtar e kishte Bacë Adem Demaçin. Xheladin Rekaliu, pas daljes nga burgu dhe izolimi, një kohë kishte punuar në Ramiz Sadiku, bashkë me Rade Novičevićin që pastaj u bë shef i UDB-së në Besianë që edhe e kishte torturuar Xhelën në Stacionin e Policisë në Podujevë. Këtë më kishte treguar Xhela dhe, ndonëse në fillim e mohonte, më vonë e pranoi edhe vet Rade Novičević. Xheladin Rekaliu ishte shumë modest, i urtë, i durueshëm, asnjëherë ankues ndonëse fati i jetës nuk ishte aspak i mëshirshëm ndaj tij. I mbetur pa punë, me shumë fëmijë, pa shtëpi normale, nuk kishte as përkrahje përveç të disa miqve dhe shokëve. Tërë pasditen e kalonte në minimarketin “Vlora” që ishte pronë e familjes sime ku mbledheshin të gjithë atdhetarët, aktivistët politikë dhe të KMDLNJ-së. Xheladin Rekaliu nuk pranonte ndihmë thuaja nga askush përveç ndaj atyre që shumë iu besonte. Për më keq, ai u diagnostifikua me kancer dhe u bë organizimi të transferohet në Tiranë për t'u dërguar pastaj në Zvicër. Në Tiranë qëndroi në banesën dhe përkujdesjen e Arif Ejupit, një veprimtar i jashtëzakonshëm kombëtar, politik dhe i KMDLNJ-së. Pasi u transferua në Zvicër dhe u vendosë në spital, një interesim të jashtëzakonshëm për të e tregoi, Hysen Shurdhani, Aga i Kaçanikut duke e vizituar çdo ditë dhe duke e marrë në banesë çdo fundjave. Hysen Shurdhani ishte

dënuar dy herë politikisht me gjithsej 15 vite burg. Kur u kuptua se nuk kishte shërim, Xhela u kthye në Besianë nën përkujdesje të familjes dhe disa shokëve. Një ditë para se të ndërton jetë, bashkë me gruan time, Fexhrije Shala, e burgosur politike, e vizitua Xhelën që ishte i mrekulluar me organizimin e UÇK-së. Në fakt, ai na tha se me daljen në skenë të UÇK-së po përmbillet misioni ynë dhe se ia ka vëllejtur çdo sakrificë. Herën tjetër tha të mos vijmë pa Bacën Adem Demaçi. Xhela iku nga kjo botë pa e pritur përfundimin e luftës por me bindje se do ta fitojmë këtë luftë. Nëse duam ta kemi portretin komplet të një njeriu të mrekullueshëm, patrioti të madh, stoiku shqiptar atëherë të gjitha këto i ka pasur XHELADIN REKALIU.

**4. BAJRUDH BEHRAMI:** Bajrush ishte patriot idealist i frymëzuar nga arti dhe artist i frymëzuar nga çështja kombëtare. Bajrushit thjesht nuk i interesonte ana materiale, ishte bohem që ëndërronte dhe punonte për çlirim dhe bashkim kombëtar. Gjithmonë i buzëqeshur, asnjëherë i mërrholur përkundër problemeve me të cilat përballej, edhe ato të mbijetesës. I dënuar me 10 vite burg, i torturuar edhe pasi përfundoi dënimin, Bajrush i ruajti fort shtyllën kurriore, pa u lakuar asnjëherë në rrugën për liri dhe bashkim kombëtar. Bajrush nuk kishte shumë shokë, shoqërohej me Hakifin dhe Lulin, kryesisht. Një kohë të madhe e kalonte me mua në “minimarketin Vlora” në Besianë. Për disa muaj e angazhova në KMDLNJ, në shërbimin për informim deri kur shkoi në UNIKOMB. Bajrush BEHRAMI ishte ushtar i bindur politik dhe jo vetëm politik i Bacë Adem Demaçit duke u angazhuar në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. Pas përfundimit të luftës, Bajrush BEHRAMI nuk mund të gjente një vend pune pavarësisht se ishte shumë modest në kërkesa. Prej të burgosurve politikë, për aq sa unë i njohë, vështirë të gjeni një më modest, më idealist dhe më babaxhan se që ishte Bajrush BEHRAMI. Ne që pastaj u burgosëm dhe u dënuam me shumë vite burg, frymëzim dhe forcën e kishim te Baca Adem Demaçi kurse zanatin e veprimit, përvojën e qëndresës, vendosmërinë për sakrificim, pa pyetur për çmim që duhej paguar e morëm nga Jahja Fusha dhe Shaban Shala, të cilët nuk i takuam kurrë ndërsa jemi të nderuar që ishim afër dhe shokë të Xheladin Rekaliut dhe Bajrush Behramit, KATËR ASETËT E SHQIPTARISË NË LLAP.

## Kryetari i Rahovecit takon tri studentet përfituese të bursës komunale

RAHOVEC, 30 GUSHT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka takuar tri nga 196 studentët përfitues të bursës komunale. “Ky takim më dha mundësinë të diskutoj me tri vajza të reja dhe ambicioze të cilat po ndjekin studimet në universitete të ndryshme në Kosovë. Beslinda Himaj, njëra nga përfitueset e bursës, është studente në Fakultetin e Shkencave të

Jetës dhe Mjedisit, në Drejtimin Agrobiznes në Universitetin ‘Ukshin Hoti’ në Prizren. Edonita Zeka, gjithashtu përfituese e bursës, studente në Fakultetin e Ekonomisë, në Drejtimin Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës ‘Hasan Prishtina’. Genta Morina është studente në Fakultetin e Mjekësisë, në Drejtimin Shëndet Publik në

Universitetin ‘Fehmi Agani’ në Gjakovë. Në bisedën tonë theksova rëndësinë e mbështetjes së studentëve dhe të investimit në arsim, si dhe përkushtimin e komunës së Rahovecit për ta vazhduar këtë mbështetje. U urova studenteve suksese të mëtejshme dhe i inkurajova të vazhdojnë të përkushtohen në studimet e tyre”, ka thënë Latifi.



## Sarrazin: Nevojiten kompromise të vështira nga Kosova dhe Serbia drejt BE-së

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 GUSHT - I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë në Prishtinë se vendet e Ballkanit Perëndimor, në veçanti Kosova dhe Serbia, duhet të jenë të gatshme për kompromise dhe koncesione jo të lehta në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.

Sarrazin tha se e vizitoi Kosovën të enjten dhe do t'i vizitojë vendet e tjera të rajonit për arritjen e rezultateve “konkrete” për njerëzit e Ballkanit Perëndimor dhe se për këtë nevojiten kompromise në prag të Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet më 14 tetor në Gjermani. “Por për këtë kemi nevojë për kompromise dhe nganjëherë madje edhe gatishmëri për koncesione për t'u pajtuar për çështje politike të cilat nuk janë të lehta as për Serbinë e as për Kosovën. Ende nuk kemi arritur ku duhet”, tha Sarrazin për gazetarë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Kosova dhe Serbia kanë shumë mospajtime dhe dialogu mes tyre për normalizimin e marrëdhënieve, i nisur qysh më 2011, ka ngecur në kohët e fundit dhe palët në vazhdimësi fajtojnë njëra-tjetrën për moszbatim të marrëveshjeve ekzistuese apo për dështim të dialogut, ndërkaq BE-ja thotë se ka mungesë të vullnetit politik për zbatimin e marrëveshjeve.

Sarrazin theksoi se bisedoi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtit, gjatë një takimi në Prishtinë, dhe se do të bisedojë edhe me liderët e pesë vendeve të tjera të rajonit gjatë javës së ardhshme për bashkëpunimin



rajonat. “U kërkoj të gjithëve të bëjnë gjithçka që është e mundur për të shprehur gatishmëri për kompromise në mënyrë që të arrihen rezultate për lëvizjen e lirë të mallrave, njerëzve, parasë dhe tregtisë në rajon për të ecur përpara drejt Bashkimit Evropian”, shtoi ai.

Zyra e Kurtit tha të enjten më vonë se gjatë takimit në mes të Sarrazinit dhe kryeministrin u bisedua për progresin në zbatimin e marrëveshjeve të mobilitetit në Procesin e Berlinit, bashkëpunimin rajonal dhe pritjet nga samiti i radhës që në 10-vjetorin e tij do të mbahet në Berlin. “Në takim u bisedua për progresin në zbatimin e marrëveshjeve të mobilitetit në Procesin e Berlinit, bashkëpunimin rajonal dhe pritjet nga samiti i radhës që në 10-

vjetorin e tij do të mbahet në Berlin. Kryeministri theksoi që në kohën kur në rajon shtyeshin platforma të tjera paralele, Kosova është angazhuar plotësisht në Procesin e Berlinit duke kërkuar ri-energizimin dhe fuqizimin e tij si një platformë që ofron barazi dhe përshpejton procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për vendet që duan të anëtarësohen. Është e rëndësishme që para samitit të radhës të arrijmë jo vetëm marrëveshje të reja por edhe të sigurojmë zbatimin e marrëveshjeve që tashmë kemi nënshkruar, tha kryeministri dhe e falënderoi z. Sarrazin për kontributin dhe rolin e tij në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë, si dhe në avancimin e bashkëpunimit

rajonat”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Procesi i Berlinit nuk është një proces formal i politikës së BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ai është një nismë e ish-kancelares Angela Merkel të Gjermanisë në vitin 2014 për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përafrimin e tyre me Bashkimin Evropian. Kjo nismë shërben si një platformë për bashkëpunimin e nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve zyrtarë të nivelit të lartë të së ashtuquajturës Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor, e cila përbëhet nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Procesi përfshin edhe institucionet e BE-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë

civile në rajon.

Vendeve të Ballkanit Perëndimor u është premtuar perspektivë evropiane prej vitit 2003 në një samit në Selanik. Nga ajo kohë, vetëm Kroacia nga vendet e rajonit është anëtarësuar në BE në vitin 2013.

Negociatat për anëtarësim ka vite që i kanë nisur Mali i Zi dhe Serbia, ndërsa në korrik të vitit 2022 i kanë nisur edhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Bosnjë-Hercegovina e ka marrë statusin e vendit kandidat në dhjetor të vitit të kaluar, ndërsa Kosova ka vetëm Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) me BE-në.

Gjatë vizitës në Prishtinë, Sarrazin u takua edhe me presidentin e Kosovës, Vjosa Osmani, si dhe me liderët e partive opozitare, Memli Krasniqin e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lumir Abdixhikun e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Presidenca e Kosovës tha se Osmani dhe Sarrazin biseduan për zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend dhe rajon, si dhe për Procesin e Berlinit. “Me këtë rast, presidentja ka ritheksuar mbështetjen e plotë për marrëveshjet e dala nga ky proces”, thuhet në njoftim.

Sarrazin u emërua në postin e të dërguarit të posaçëm për Ballkanin Perëndimor në shkurt të vitit 2022. Prej atëherë ai ka zhvilluar një sërë vizitash në Kosovë dhe në vende të tjera të rajonit. Ai ka qenë për herë të fundit në Kosovë në majin e këtij viti. Në qershor ka qenë në Serbi, ku është takuar me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, me të cilin ka biseduar për dialogun për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

## Bulliqi dhe zëvendësministri i Zhvillimit Rajonal diskutojnë për projekte të ndryshme

Podujevë, 30 gusht - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim zëvendësministrin e Zhvillimit Rajonal, Ali Tafarshiku dhe ushtruesen e detyrës së drejtoreshës së Agjencisë së Zhvillimit Rajonal, Mimoza Tafarshiku. Bulliqi e ka falënderuar

zëvendësministrin Tafarshiku për përkrahjen financiare që kjo ministri i ka dhënë komunës për realizimin e projekteve, siç është Stacioni i Autobusëve, ndërkohë që e njoftoi edhe për zhvillimin e procedurave për ndërtimin e Tregut të Gjellbër që, po ashtu, realizohet në

bashkëfinancim me këtë MINISTRI.

Bulliqi e Tafarshiku diskutuan edhe për projekte të tjera që priten të realizohen me bashkëfinancim ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, të cilat do të jenë në interes të madh për qytetarët e Podujevës.



## Murati dhe ambasadori i Britanisë diskutojnë për investimet në Kosovë



PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka pritur në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Gjatë këtij takimi ministri Murati dhe ambasadori Hargreaves kanë diskutuar lidhur me mundësitë për bashkëpunim të mëtutjeshëm ndërmjet dy vendeve, duke shqyrtuar mundësitë për investime në infrastrukturë

dhe sport, me theks të veçantë në organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Një temë tjetër e rëndësishme e diskutuar në këtë takim ishte rritja e investimeve në Kosovë. Lidhur me këtë, ministri Murati theksoi programin "Dritarja e Investimeve të Diasporës" të lansuar nga qeveria në korrik të këtij viti, që ka për qëllim mbështetjen e bashkatdhetarëve që duan të

kthehen dhe investojnë në Kosovë. Rritja e të hyrave, lufta ndaj korrupsionit, si dhe mundësitë për rritjen e eksportit ishin disa nga temat e tjera të diskutuara në këtë takim. Të dyja palët vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehën vullnetin që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Çmimet e importit, më të larta në tremujorin e dytë 2024 sesa në atë të 2023-s

PRISHTINË, 30 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2024, viti bazë 2010=100.

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati rënie për -1.1% në TM2 2024 krahasuar me TM1 2024. Ndërkaq, krahasuar TM2 2024 me TM2 2023, çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 1.0%.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve, lëkura dhe artikujt e saj (-14.5 %), produktet minerale (-4.6 %), artikujt e ndryshëm të prodhuar (-2.9 %), tek instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikorë dhe mekanizmat e orës (-2.9 %), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (-2.8 %), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike

(-1.1 %), produktet e industrive kimike (-0.4 %) dhe artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani (-0.1 %).

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 1.0% në mes TM2 2024 krahasuar me TM2 2023. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te produktet bimore (16.7 %), këpucët (8.5 %), vajrat ushqyese (6.8 %), mjetet e transportit (2.8 %), artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (2.5 %) etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit lëkura dhe artikujt e saj (-17.7 %), instrumentet optike, fotografike, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (-3.3 %), artikujt e ndryshëm të prodhuar (-2.3 %), produktet minerale (-1.5 %), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-1.3 %) etj.



## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit për projektin 'Parku Industrial në Lipjan'



PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin e Parkut Industrial në Qylagë - Lipjan. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) do ta financojë projektin/kontratën "Ndërtimi i infrastrukturës fizike në Parkun Industrial në Lipjan, faza e V" brenda kufijve buxhetorë të paraparë në harmoni me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Vlera e parashikuar e

investimit për ndërtimin e infrastrukturës fizike të këtij parku faza V (pestë) do të jetë deri në 2,672,554.61 euro për realizimin e kontratës.

Përgjatë viteve 2022-2023, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka ndarë mjete financiare dhe ka investuar në këtë park industrial në një shumë prej 600,000 eurosh, gjersa me këtë marrëveshje trevjeçare parashihet një investim në vlerë totale prej 2,672,554.61 eurosh, ku nga kjo vlerë MINT do të financojë 2,000,000 euro, ndërsa komuna e Lipjanit 672,554.61 euro për vitet 2024-2026.

## Shala i PDK-së: Termocentrali Kosova B është në gjendje alarmante mjedisore

PRISHTINË, 30 GUSHT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se gjendja mjedisore në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) është alarmante. Ai ka publikuar një video në "Facebook", e cila pasqyron gjendjen në Termocentralin

Kosova B. Shala ka thënë se ndotja e mjedisit nga KEK-u është e dëshmuar me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar. "Sot në KEK, përkatësisht në Termocentralin Kosova B, gjendje alarmante mjedisore! Kjo është situata

reale menaxhuese e Termocentraleve të Kosovës pas katër viteve të kësaj Qeverie. Ndotja në shkallë shqetësuese dhe jashtë çdo norme. Shkarkimet në ketë nivel, janë të dënueshme me çdo legjislacion vendor dhe ndërkombëtar", ka shkruar Shala.





# Luftëtarët e Revolucionit të Haitit

Nga: Emi ELEODE / BBC

Natën e 23 gushtit 1791 në Kepin Francez në bregun verior të San Domingos (Haiti i sotëm), zjarret shpërthyen në plantacione. Të robëruarit ua vunë zjarrin ndërtesave dhe fushave dhe vranë sunduesit e tyre. Ishte fillimi i Revolucionit të Haitit, e vetmja kryengritje e njohur e njerëzve të skllavëruar në histori që çoi në themelimin e një shteti që ishte i lirë nga skllavëria.

Ndërkohë, në anën tjetër të Atlantikut, në Francë përhapeshin me shpejtësi lajmet për kryengritjen. Shqetësoheshin elita e pasur në pushtet dhe ata me monopol në tregtinë transatlantike të skllavërve. Filluan të kuptojnë se po mbaronin ditët e tyre të përfitimit nga nënshtrimi i popullatës së robëruar. Sulmet e koordinuara ishin fillimi i rezistencës së armatosur që u ngrit në të gjithë vendin në vitet në vijim.

Rebelimet e skllavërve përfundimisht çuan në atë që nuk paramendohej më parë: shpërbërja e sistemit kolonial dhe shpallja e pavarësisë së Haitit në vitin 1804. Ishte “revolta e parë e suksesshme nga njerëzit e skllavëruar” dhe vendi u bë republika e parë e zezë e lirë në botë dhe shteti i parë i pavarur në Karaibe.

Historia i kujton më së shumti të bëmat e luftëtarëve meshkuj të Revolucionit të Haitit. Figurat e tilla si udhëheqësi i saj, gjenerali Toussaint Louverture; Jean-Jacques Dessalines, i cili u bë sundimtari i parë i Haitit të pavarur; Dutty Boukman i cili ishte udhëheqës i luftëtarëve dhe prift i vudusë ose një hungan; mbreti i parë dhe i vetëm i Haitit, Henri Christophe etj. Historitë e tyre përkujtohen gjatë gjithë kohës.

Megjithatë, kishte edhe gra që kishin role kyçe në luftën për pavarësinë e Haitit. Pjesa më e madhe e historisë së tyre është e panjohur nga shumica, ose e anashkaluar për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe të dhënave të aktiviteteve të tyre. Megjithatë, historitë që njohim për gratë, duke përfshirë emrat si Sanité Bélair, Cécile Fatiman, Marie-Jeanne Lamartinière, Catherine Flon, Suzanne Simone Baptiste Louverture etj., detajojnë vendosmërinë, guximin dhe përkushtimin e tyre ndaj kauzës përkundër rreziqeve.

Ka gjithashtu mungesë të provave vizuale të këtyre grave. Megjithatë, artistët bashkëkohorë Richard Barbot dhe François Cauvin – që të dy haitianë – i kanë rimenduar duke ua dhënë emrave edhe fytyrat.

Dr. Crystal Nicole Eddins, profesore e sociologjisë në Universitetin e Pitsburgut thotë se gratë përdorën taktika të



ndryshme të rezistencës, nga veprimi i hapur deri te puna në heshtje në prapaskenë. Disa, duke përfshirë emrat si Bélair dhe Lamartinière, luftonin në vijën e frontit. “E dimë se gratë mbanin armët përkrah burrave. Gratë nga shoqëritë afrikane kishin gamë të gjerë rolesh shoqërore, disa prej të cilave ishin ushtarake – përveç faktit që punonin edhe në plantacione, duke e kryer të njëjtën punë si burrat. Pra, rezultoi se luftonin të njëjtën luftë”.

Kishte shëruese dhe infermiere si Catherine Flon – e cila njihet kryesisht si rrobaqepëse dhe thuhet se kishte qepur flamurin e parë të Haitit të pavarur – si dhe edukatore, spiune dhe sabotatore që përdorën taktikat guerile për të shkatërruar burimet, duke përfshirë furnizimin me ujë të armiqve. Eddins shpjegon se gratë gjithashtu kontribuan në rolet më femërore, si rritja dhe sigurimi i ushqimit për ushtritë rebele dhe komunitetet e tyre. Sanité Bélair ishte udhëheqëse revolucionare që shërbeu te ushtaraku Toussaint Louverture. U ngrit në grada, fillimisht si rreshtere dhe më pas togere, duke udhëhequr sulmin në ekspeditën e San Domingos. Së bashku me bashkëshortin e saj Charles Bélair, një tjetër toger në ushtri, ata u kapën dhe u ekzekutuan me urdhër të Napoleonit. Trashëgimia e Bélairit përkujtohet me portretin e saj në kartëmonedhën haitiane të 10 gurdëve, krijuar në vitin 2004 si pjesë e një serie që shënon 200-vjetorin e pavarësisë së Haitit.

Më pak të njohura ishin priftëreshat e vudusë (mambo)

dhe gratë e fuqishme shpirtërisht si Cécile Fatiman, të cilat ua dhanë “magjitë e mbrojtjes” rebelëve dhe refuzuan të jepnin informacionet për vendndodhjen e tyre. Ato i përdorën gjithashtu njohuritë e tyre tradicionale të mjekësisë bimore për të helmuar pronarët e skllavërve. Nga nëna një skllave afrikane dhe nga babai që ishte princ korsikan, Fatimani ishte mambo dhe revolucionare e shquar, e cila gjithashtu thuhet se kishte krijuar rrjete komunikimi që bartnin informacionet nëpër plantacione. Vdiq në moshën 112 vjeçe.

Marie-Jeanne Lamartinière ishte ushtare dhe infermiere nga Haiti, e cila shquhet jo vetëm për guximin e saj, por edhe për njohuritë dhe strategjinë e saj në fushën e betejës. Lamartinière ishte figurë kryesore në Betejën e madhe të Krete-a-Pieros më 1802, kundër forcave franceze.

Gratë nuk ishin të përgjithshme nga dënimet për pjesëmarrjen në revolucion dhe ato pësuan të njëjtat fate brutale si burrat. Bélair kishte refuzuar t’ia mbyllin sytë para se të ekzekutohej nga francezët, së bashku me burrin e saj.

Me ato pak detaje që dimë për Bélairin dhe gratë e tjera, kronistët kanë shkruar për trimërinë dhe vendosmërinë për kauzën e çlirimit. “Në disa raste, historianët kanë thënë se ishin gratë ato që ishin më të rrepta në luftë”. Ato e përmbysën shtypjet koloniale dhe, përballë fatkeqësive, luftuan për lirinë brenda komuniteteve të tyre dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Kolonistët krijuan ndarje midis të

skllavëruarve – duke mbjellë mosmarrëveshje me sistemet e shpikura hierarkike që përfshinin fenë dhe ngjyrën e lëkurës. Duke e përdorur taktikën përçajë dhe sundo, shpresonin se do të ishin shumë të zënë duke luftuar mes vete e jo për të thyer zinxhirët e skllavërisë. Përveç kësaj, ata kërcënuan me dhunë ekstreme si ndëshkim për kryengritjen. Megjithatë, kjo nuk e pengoi dëshirën për çlirim të popullit të robëruar. Organizuan revolta pa dijeninë e zotërinjve të tyre, të cilët ishin të mashtruar nga ndjesia se janë të sigurt sepse zezakët ishin inferiorë dhe të paafte për të luftuar për vetveten. Ky besim vazhdoi veçanërisht në mënyrën se si konsideroheshin gratë e zeza. Shumë nga ato morën pozita udhëheqëse në rebelimet e organizuara, megjithëse nuk dimë shumë për historitë e tyre. Eddins thotë se literatura më e re po heton se pse këto gra u heshtën në dosjet historike. Statusi i tyre i skllavërisë ka të bëjë me këtë, ka thënë profesoresha e historisë Jennifer L. Morgan. Eddins shprehet: “[Profesoresha Morgan] flet për mënyrën sesi statusi i skllavit bartej përmes barkut të grave afrikane, se ata që skllavëronin nuk donin t’i shihnin si njerëz, sepse nëse e shihnin një grup shtatzënë, kjo ua kujtonte se njerëzit afrikane kishin farefisni dhe familje”. Gjithashtu, skllavëruarit nuk kishin gjasa t’i shihnin gratë e zeza si revolucionare ose rebele.

Një arsye tjetër për mungesën e dukshmërisë së tyre në librat e historisë, është fakti se nuk ka mjaft rrëfime në vetën e parë të këtyre grave. Eddins thotë: “Kemi letra nga Toussaint Louverture.

Kemi shkrime nga Jean-Jacques Dessalines, por nuk kemi, të paktën në dijeninë time, shkrime të njohura nga ndonjë grua revolucionare. Pra, në mungesë të kësaj, duhet kreativitet për t’u përpjekur që të kuptojmë se si t’i gjejmë këto gra dhe të njohim historitë e tyre”. Me projektin e saj të radhës, Eddins shpreson të gjejë gra të tjera si Fatiman dhe Bélair, dhe t’i bëjë më të dukshme historitë e grave revolucionare nga Haiti.

Fatiman dhe Dutty Boukman drejtuan ceremoninë sekrete, që ishte jo vetëm ritual fetar, por edhe takim për të mobilizuar masat e skllavëruara nga plantacionet në të gjithë vendin. Ato hartuan strategji për shkatërrimin e “ekonomisë së plantacioneve të sheqerit dhe përshkruan kushtet e çlirimit të tyre”. Ceremonia dhe rituali të tjerë vudu që përfshinin burrat dhe gratë ishin thelbësore për të sjellë solidaritet racor midis popullatës së ndryshme në Haiti që përfshinte të skllavëruarit, kreolët, afrikantët, njerëzit e lirë me ngjyrë dhe marunët.

Pavarësia erdhi me një kosto dhe vendi ende po vuan efektet e revolucionit. Megjithatë, është e rëndësishme të pranohet se përmbysja e guximshme e skllavërisë dhe krijimi i Haitit të pavarur ishte fitore e përbashkët e burrave dhe grave. Dhe, derisa ekzistojnë shumë burime që fokusohen në burrat e Revolucionit Haitian, përpjekjet e fundit janë bërë për të gjetur historitë e grave të revolucionit dhe për t’i nxjerrë ato në dritë – jo vetëm për kontributin e tyre në kauzë, por edhe për të kuptuar përvojat e tyre të jetuara. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Ademi: Fjalët e trajnerit të Legias nuk qëndrojnë, fusha është në gjendje shumë të mirë

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Trajneri i Legias së Varshavës, Goncalo Feio, e ka kritikuar fushën e stadiumit "Fadil Vokrri" pas fitores që arriti skuadra e tij ndaj Dritës së Gjilanit në kuadër të Ligës së Konferencës. "Nuk e prisja që fusha të kishte një ndikim kaq të madh në rrjedhjen e ndeshjes. Duke parë skuadrën time, pyesja veten nëse kishim bërë gjënë e duhur në stërvitje në Poloni, sepse vërtet nuk mund ta përballonim fushën. Ishte e vështirë për ta lëvizur topin. Kjo është diçka për të menduar. Ishte një ndeshje në një terren të vështirë, kishte kushte jo të mira. Duhet të jemi të vetëdijshëm se ngarkesa e nyjave të futbollistëve pas një ndeshjeje në një fushë të tillë është më e madhe, prandaj duhet të kemi kujdes", ka deklaruar Feio pas ndeshjes. Ndërsa të premten trajnerit në fjalë i është kundërpërgjigjur presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili ka publikuar foto nga gjendja e stadiumit "Fadil Vokrri". "Kështu duket sot fusha e stadiumit 'Fadil Vokrri' pas ndeshjes Drita - Legia. Edhe pse gjatë punimeve të kësaj fushe ka marrë kohë me temperatura shumë të larta, fusha është në gjendje shumë të mirë. Arsyetimet e trajnerit të Legias, se për shkak të fushës së dobët nuk



patëm lojë, nuk qëndrojnë, sepse të gjithë e dinë se fusha është hibride dhe e standardeve më të larta, prandaj konstatimet e tilla nuk kanë të bëjnë asgjë me realitetin. Fusha është aty dhe mund të vizitohet nga çdokush dhe të kënaqet me një fushë e cila është e kualitetit të fundit", ka thënë Ademi. Më pas numri një i FFK-së e ka falënderuar MKRS-në dhe ministrin Hajrulla Çeku për investimin e bërë në këtë fushë, derisa Kosovës i ka uruar nisme të mbarë në ndeshjet e Ligës së Kombeve. "Falënderojmë MKRS-në

dhe ministrin Hajrulla Çeku për investimin në këtë fushë, e cila ka arritur standarde të shkëlqyeshme. E gëzofshin të gjithë ata që kanë mundësi të luajnë në këtë fushë dhe besoj fuqishëm që më së miri këtë e vlerësojnë futbollistët. Uroj që në këtë fushë kombëtarja jonë ta nisë mbarë edicionin e ri të Ligës së Kombeve kundër Rumanisë. Po ashtu, ftoj të gjithë që të jenë në përkrahje të kombëtares, sidomos 'Dardanët' të jenë në stadium sa më kreativë e në nivel si gjithmonë", ka shtuar Ademi.

# Foda publikon listën e Kosovës për dy ndeshjet e shtatorit në Ligën e Kombeve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Franco Foda, e ka bërë publike listën e futbollistëve që do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet e para të edicionit të ri të Ligës së Kombeve kundër Rumanisë dhe Qipros, që zhvillohen më 6 dhe 9 shtator. Në listën e përzgjedhësit Foda janë 25 futbollistë, teksa krahas listës kryesore janë edhe disa futbollistë në listën rezervë dhe varësisht nga rrethanat ata do të mund të përfshihen në kombëtare. Risi në listën e Fodës është emri i mesfushorit Elvis Rexhbeçaj, si dhe sulmuesit të ri Eliot Bujupi, i cili ka luajtur më parë me Kosovën U-19 dhe Fisnik Asllani, gjithashtu. Foda ka ftuar edhe lojtarë nga Superliga e Kosovës si Ilir Avdyli, Ilir Krasniqi dhe Lindon Emërllahu, ndërsa nuk mungojnë as emra të tjerë që janë larguar së fundmi si Ermal Krasniqi, Albion Rrahmani dhe Emir Sahiti. "Dardanët" i nisin përgatitjet për këto dy ndeshje të hënën, me stërvitjen e



parë që do të zhvillohet në orën 17:45, në Kampin Nacional në Hajvali. Ndërkaq, në të njëjtën ditë, paraprakisht përzgjedhësi Foda do të mbajë konferencë për medie në hotel "Emerald" në orën 13:00. Kosova është pjesë e Grupit 2 në Ligën C ku, përpos Rumanisë e Qipros, do të përballlet edhe me Lituaninë.

## LISTA E FUTBOLLISTËVE

A. Muriq, V. Bekaj, I. Avdyli, A. Rrahmani, M. Vojvoda, M. Kryeziu, F. Hadergjonaj, I. Kasniqi, D. Rrudhani, L. Dellova, F. Aliti, L. Paqarada, V. Berisha, L. Emërllahu, E. Rexhbeçaj, F. Muslija, E. Zhegrova, M. Rashica, E. Krasniqi, E. Sahiti, F. Asllani, A. Selmani, E. Bujupi, A. Rrahmani, V. Muriqi.

## SHKURT

### FC Ferizaj transferon sulmuesin Juozas Lubas

FC Ferizaj e ka transferuar sulmuesin e krahut, Juozas Lubas, nga Lituania. Sulmuesi në fjalë skuadrës së Kosovës i bashkohet nga Shqipëria ku ishte pjesë e Egnatias. "FC Ferizaj ka kënaqësi t'ju njoftoj se ka arritur marrëveshje me sulmuesin e krahut, lituanezin Juozas Lubas. Lubas vjen pas një eksperience të suksesshme në Superligën e Shqipërisë, ku me skuadrën e Egnatias, arriti të shpallet kampion dhe fitues i kupës. Me këta të fundit ai luajti edhe në ndeshjet kualifikuese në garat evropiane. Lubas përndryshe është pjesë edhe e kombëtares U21 të Lituanisë, e më herët ka qenë pjesë e të gjitha grupmohave të këtij shteti", thuhet në njoftimin e FC Ferizajt. Skuadra e Ferizajt pas tri ndeshjeve në Superligë ka grumbulluar katër pikë.

### Mungojnë ofertat, Hysaj prit të qëndrojë te Lazio

Elseid Hysaj ka qenë një nga emrat më të lakuar të Lazios në merkaton e verës. Shumë media italiane kanë bërë me dije se ai nuk bën më pjesë në planet e trajnerit Tudor. Shpesh është thënë se mbrojtësi i kombëtares shqiptare është lënë i lirë nga drejtuesit e klubit që të largohet, por duke qenë se nuk ka pasur asnjë ofertë konkrete për të, e ardhmja e tij është në dyshim. Së fundmi gazetari i njohur italian, Nikolo Shira, përmes një postimi në profilin e tij zyrtar në "X", shkruan se Hysaj mund të qëndrojë në klub dhe të bëhet pjesë e skuadrës titullare.

### Carlos Alcaraz eliminohet nga US Open

Superylli spanjoll Carlos Alcaraz u eliminua nga US Open nga numri 74 i botës holandeze Botic van de Zandschulp në një përmbysje sizmike në raundin e dytë të enjten. Numri tre i botës dhe kampioni i vitit 2022 Alcaraz humbi 6-1, 7-5, 6-4, duke i dhënë fund përpjekjes së tij për t'u bërë vetëm njeriu i tretë në epokën moderne që fiton French Open, Wimbledon dhe US Open në të njëjtin sezon. Alcaraz kishte arritur të paktën çerekfinalen në tri paraqitjet e tij të mëparshme në Nju-Jork dhe humbja e së enjtes ishte më e hershmja e tij në një Grand Slam që nga një dalje në raundin e dytë në Wimbledon më 2021. "Unë jam pak i humbur, jam pa fjalë", ka thënë van de Zandschulp pas fitores së tij të dytë në karrierë ndaj një lojtari të topesëshes. Alcaraz, të cilit i duheshin katër sete për ta larguar kualifikuesin australian Li Tu në raundin e parë, u shfaq në fushë me kofshën e majtë të lidhur.

## Hamiltoni: Antonelli duhet të jetë pasardhësi im te Mercedesi

LONDËR, 30 GUSHT - Formula 1 do të vazhdojë këtë fundjavë në pistën e Monzas, në shtëpinë e Ferrarit, ajo që do të jetë makina e ardhshme e 7 herë kampionit të botës, britanikut Lewis Hamilton. Ndaj ai pret një mikpritje edhe më të zjarrtë nga tifozët e "kokëkuqes",

pavarësisht se garon ende për Mercedesin. "Këtu është gjithmonë një garë e veçantë, por këtë herë do të jetë edhe më shumë. Gjithmonë jam pritur mirë edhe kur po luftoja me Ferrarin. Por këtë herë është e veçantë. Klima, pasioni..., por tashmë në Imola

ishite fantastike", tha Lewis Hamilton. Për objektivat në këtë fundjavë, ai ka shtuar: "Pas Holandës ne shqyrtoam disa gjëra që duhej t'i kishim bërë ndryshe. Duhet të kishim bërë më mirë në kualifikime, por mësuam shumë nga fundjava e kaluar,

ndaj do të shohim". "Ne do të prezantojmë disa përditësime, por nuk do të jemi të vetmit, shpresoj se mund të jemi atje për të luftuar. Pasardhësi im te Mercedesi? Unë mendoj se duhet ta zgjedhin Antonellin. Ai ka një të ardhme të ndritur përpara. Jam i emocionuar ta



shoh atë në vitet e ardhshme dhe mezi pres ta shoh rrugën e tij në F1", ka deklaruar Hamilton.

## Sylvinho publikon listën për ndeshjet ndaj Ukrainës dhe Gjeorgjisë

TIRANË, 30 GUSHT - Kombëtarja shqiptare do të luajë dy ndeshje në shtator ndaj Ukrainës dhe Gjeorgjisë, të vlefshme për Ligë e Kombeve. Përgatitjet për dy ndeshjet e para në Grupin B1 do të nisnin të hënë më 2 shtator, teksa trajneri Sylvinho ka publikuar të premtën listën me 24 lojtarë të grumbulluar. Përsa i përket portës janë Thomas Strakosha, Alen Sherri dhe Simon Simoni. Në mbrojtje rikthehet futbollisti i Partizanit, Andi Hadroj. Emrat e tjerë që përbëjnë repartin e prapavijës janë Berat Gjimshiti, Elseid Hysaj, Ivan Balliu, Mario Mitaj, Marash Kumbulla, Ardian Ismajli dhe Enea Mihaj. Në repartin e mesfushës dhe të sulmit ka dy risi. Trajneri Sylvinho ka vendosur të thërrasë për herë të parë në Kombëtaren A mesfushorin Sebastian Spahiu dhe sulmuesin Agim Zeka. Të dy futbollistët më parë kanë qenë pjesë e Shqipërisë U-21. Spahiu aktivizohet në Iran me skuadrën e Mes Rafsanjan, ndërsa Zeka në kampionatin

LISTA E EKIPIT KOMBËTAR "A"	
<b>PORTIERË</b>	<b>MESFUSHORË</b>
THOMAS STRAKOSHA ALEN SHERRI SIMON SIMONI	YLBER RAMADANI AMIR ABRASHI KRISTJAN ASLLANI MEDON BERISHA QAZIM LACI NEDIM BAJRAMI ARBËR HOXHA JASIR ASANI SEBASTJAN SPAHIU
<b>MBROJTËS</b>	<b>SULMUES</b>
ELSEID HYSAJ IVAN BALLIU ANDI HADROJ MARIO MITAJ BERAT GJIMSHITI MARASH KUMBULLA ARDIAN ISMAJLI ENEJA MIHAJ	AGIM ZEKA REV MANAJ ARMANDO BROJA TAULANT SEFERI
<b>TRAJNER</b>	
SYLVIO MENDES CAMPOS JUNIOR	

"Abissnet Superiore" me Partizanin. Pjesa tjetër e lojtarëve që përbëjnë repartin e mesfushës dhe të sulmit janë Ylber Ramadani, Amir Abrashi, Kristjan Asllani, Medon Berisha, Qazim Laçi, Nedim Bajrami, Arbër Hoxha, Jasir Asani, Rey Manaj, Armando Broja dhe Taulant Seferi. Grumbullimi i lojtarëve do të nisë që të dielën në Tiranë me futbollistët që do të përfundojnë më herët impenjimet me skuadrat e tyre, ndërsa grupi i lojtarëve pritet

të jetë i plotë të hënë më 2 shtator. Seancat stërvitore do të zhvillohen në "Shtëpinë e Futbollit", ndërsa të premtën kuqezinjët do të udhëtojnë drejt Çekisë, aty ky më 7 shtator do të luhet ndeshja e parë në Grupin B1 të Ligës së Kombeve ndaj Ukrainës, në stadiumin "Epet Arena", në orën 20:45. Tri ditë më pas më 10 shtator, Kombëtarja shqiptare do të luajë ndaj Gjeorgjisë në stadiumin "Air Albania", në orën 20:45.

## Ronaldo: Nuk jam penduar që shkova në Arabi

RIAD, 30 GUSHT - Cristiano Ronaldo, ish-sulmuesi i Juventusit, Real Madridit dhe Manchester Unitedit, pesë herë fitues i Ligës së Kampionëve, u vlerësua lojtari me më shumë gola të shënuar në top-kompeticionin evropian për klube. "Liga e Kampionëve është një kompeticion legjendar. Ishite fantastike të luaja dhe shënoja kaq shumë në të. Kur fillon himni çmendesh fare. Është fantastik. Kam kujtime fantastike nga ndeshjet e Ligës së Kampionëve dhe jam i lumtur që e marr këtë mirënjohje. Nuk pendohem për zgjedhjen time për të shkuar në Arabi, por do të shohim se çfarë do të ndodhë. E ardhmja është e paparashikueshme", ka thënë Ronaldo. I pyetur se cili ka qenë momenti më i mirë në Ligën e Kampionëve, Ronaldo është përgjigjur: "Është e vështirë ta them, por ndoshta Liga e Kampionëve e



parë e fituar me Manchester Unitedin, me golin tim në Moskë. Një nga të preferuarit e mi. Më pas duhet ta përmend qartë Real Madridin, fitimin e Ligës së Kampionëve të dhjetë më 2014, në Portugal, para popullit tim. Liga e Kampionëve është një kompeticion detajesh të vogla, shumë e vështirë

për t'u fituar". Portugezi është pyetur edhe se a ka ende vende bosh për të vendosur çmime të tjera në "palmaresin" e tij, Ronaldo ka deklaruar: "Ka gjithmonë vend për trofe dhe çmime të reja, madje edhe në Madeira. Të gjithë jeni të ftuar të vini dhe ta shihni dhomën time të trofeve".

### SHKURT

#### Liverpooli ofron Diazin dhe para për Rodrygon

Futbollisti i Real Madridit, Rodrygo, po kërkohet nga shumë klube evropiane, përfshirë edhe Liverpoolin. "Të Kuqtë" kanë vendosur t'i ofrojnë shërbimet e "fantazistit" kolumbian Luis Díaz si dhe një shumë të caktuar parash për ta bërë të mundur transferimin e 23-vjeçarit brazilian në "Anfield Road". Kolumbiani është prej kohësh në listën e dëshirave të rivalëve historikë të "Los Blancos", Barcelona, por mund të përfundojë te "galaktikët", gjithmonë nëse kampionët e Spanjës dhe Evropës pranojnë shkëmbimin me Liverpoolin, mirëpo fillimisht këta të fundit duhet ta bindin brazilianin Rodrygo, i cili, pavarësisht çdo gjëje, është i lumtur në "Santiago Bernabeu" dhe dëshiron të qëndrojë aty.

#### Ancelotti pas barazimit kundër Las Palmas: Po na mungon ekuilibri

Real Madridi barazoi 1-1 kundër Las Palmas të enjten mbrëmë. "Los Blancos" nuk po bindin në këtë fillim sezoni duke marrë vetëm një fitore në tri ndeshjet e para në La Liga, përkundër se janë llogaritur favoritët kryesorë për titull. Pas barazimit të fundit ndaj Las Palmas, trajneri Carlo Ancelotti ka shpjeguar arsyen e paraqitjes së dobët të ekipit të tij. "Nuk kam parë ndonjë përmirësim në krahasim me ndeshjen me Mallorcan. Duhet të mbajmë shumë të vuajmë pak për momentin, skuadra nuk është e ekuilibruar, nuk jemi të shpejtë në lëvizjen e topit, e kemi të vështirë ta rikuperojmë atë", ka thënë Ancelotti. "Mendoj se pjesa e parë ishte e keqe. Ne luftuam për ta gjetur ekuilibrin. Nuk mund të kërkojmë justifikime, duhet të kërkojmë përmirësim të shpejtë. Po na kushton më shumë sesa pritej. Unë e marrë përgjegjësinë. Është një problem futbollit. Kur nuk e kemi topin, ne luftojmë për të qenë kompakt, ne lëmë hapësirë midis linjave. Unë duhet ta gjej zgjidhjen, jo lojtarët", ka shtuar Ancelotti.

#### Arsenali, gati ta rrëmbejë Comanin nga Bayerni

Arsenali po që të bëjë një goditje të fundit në merkato. "Topçinjtë" duan që të afrojnë edhe sulmuesin e Bayern Munchenit, Kingsley Coman, ndërsa merkato e Premierë Ligës mbyllet të premtën. Trajneri Mikel Arteta dëshiron të nënshkruajë me një tjetër futbollist në ofensivë, pasi kërkon që ta shtojë konkurrencën. Por Coman ka marrë edhe oferta nga Arabia Saudite, ndërsa dëshira e tij është të largohet nga Bayerni. Drejtuesit anglezë e dinë se do të duhet të shpenzojnë për lojtarin, për më tepër që ai ka marrë një ofertë të majme nga Lindja e Mesme. Aktualisht futbollisti paguhet 400 mijë euro në javë nga gjigandët bavarezë. Kontrata lojtarit i përfundon pas tre viteve. Sipas "Daily Mail", anglezët janë gati t'i paguajnë futbollistit të njëjtën pagë si gjermanët, por kjo do të jetë ofertë më e ulët sesa ajo nga Arabia Saudite, me klubin e Al Hilalit në pole-position.

## Curry përgjithnjë me Warriorsin, rinovim me shifra rekord për heroin e Amerikës në Olimpiadë

Basketbollisti Stephen Curry ka rinovuar kontratën me Golden State Warriors deri në vitin 2027. Pra, ai e ka shtyrë edhe për një sezon kontratën e mëparshme, duke garantuar se do të luajë në NBA deri në moshën 39-vjeçare. Një vendim

që duket se do të konfirmojë idenë se ai do të luajë vetëm me këtë klub në karrierën e tij. Fanellën e Warriorsit e ka veshur për herë të parë në NBA që nga viti 2009. Shtesa 62.6 milionë dollarë është garantuar në kontratën e re, një

rekord për një sezon të vetëm. Kështu, Curry do të kalojë 500 milionë dollarët e fituara vetëm me paga. Si ai deri tani janë vetëm LeBron James dhe Kevin Durant. Curry ishte protagonist në Olimpiadën e fundit për

kombëtaren amerikane, duke realizuar 17 trepikësha në dy ndeshjet e fundit: Në gjysmëfinale ndaj Serbisë dhe në finale ndaj Francës. Ishin këto pikë që i dhanë Amerikës medaljen e artë. Aimbetbet nën urdhrat e trajnerit Kerr i cili e ka

drejtuar edhe në kombëtare. Ai mbetet pavarësisht se nuk arriti të kualifikohet në "play-off"-in e 2024-s. Nuk ishte faji i tij, pasi për të 12-tin vit radhazi ai shënoi mbi 20 pikë për ndeshje. Curry do të ketë mentor për lojtarët e rinj.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 30.08.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

## Shpallje Publike

**T-24-12**

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000

Personi Kontaktues: Hysni Beqiri

E-mail: hysni.beqiri@trepcasha.com

Telefoni: +381 28 538 050

Faks: +381 28 539 202

## Shpallja Publike

### Qëllimi i ofertës:

#### Loti 1

- Dhënie me qera e parcelave dhe objektit të Njesisë Biznesore Industria Kimike.

Parcela me numer 4A- Pranë Magjistralës së Adriatikut, Parcela me numer 9A- Pranë Magjistralës së Adriatikut, dhe Depoja e pjesëve rezervë.

#### Loti 2

- Dhënie me qera e parcelës dhe objektit të Njesisë Biznesore Fabrika e Akumulatorëve.

Parcela, dhe Depoja e garderobës.

#### Loti 3

- Dhënie me qera e objektit të Njesisë Biznesore Metalirgjia e Zinkut- Puntoria e Elektros – objekt, hapësirë në kuadër të Puntorisë së Makinerisë

#### Loti 4

- Dhënie me qera objekteve dhe hapsirës së betonuar të Njesisë Biznesore Fabrika e Paisjes së Procesit-FPP.

Ndërtesa e Administratës, Depoja e Bombolave, Sipërfaqe e betonuar në oborrin e FPP-së

- Sipërfaqe dhe çmimi fillestar

### 1. Njësia Biznesore Industria Kimike

#### Loti 1

#### 1.Çmimi fillestar

Njësia Biznesore: Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e pambluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Parcela me numër 4A - Magjistralla e Adriatikut	750	0.50	0.09	0.59	442.50
2	Parcela me numër 9A - Magjistralla e Adriatikut	2000	0.50	0.09	0.59	1180.00
3	Depoja e pjesëve rezervë	750	0.59	0.106	0.70	522.15

### 2. Njësia Biznesore Fabrika e Akumulatorëve

#### Loti 2

#### 2.Çmimi fillestar

Njesia Biznisore: Fabrika e Akumulatorëve												
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Sipërfaqja e pambluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Parcelë	1500	0.30	0.054	0.35	531.00	0	0	0	0	0	0
2	Depoja e garderobave	940	0.65	0.12	0.77	720.98	100	0.30	0.05	0.35	35.40	756.38

### 3. Njësia Biznesore Metalurgjia e Zinkut

#### Loti 3

#### 3.Çmimi fillestar

Njesia Biznisore: Metalurgjia e Zinkut												
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Sipërfaqja e pambluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Punëtoria e Elektros (objekt-hapësirë në kuadër të "Punëtorisë së Makinerisë")	162	2.07	0.373	2.44	395.70	150	0.60	0.11	0.71	106.20	501.48

### 4. Njësia Biznesore Metalurgjia e Zinkut

#### Loti 4

#### 4.Çmimi fillestar

Njesia Biznisore: Fabrika e Paisjeve të Procesit												
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Sipërfaqja e pambluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Ndërtesa e administratës	687	0.90	0.16	1.06	729.59	0	0	0	0	0	0
2	Depoja e bombolave	227.78	2.00	0.36	2.36	537.56	100	0.50	0.09	0.59	59.00	596.56
3	Sipërfaqe e betonuar në oborr					0	200	0.50	0.09	0.59	118.00	118.00

Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes:	30.08.2024
Sqarimi:	deri me 17.09.2024
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 17.09.2024 Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur) (Originali dhe Kopja)
Afati i fundit i dorëzimit:	17.09.2024 në 11:00
Vendi i dorëzimit:	Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

#### Shënime shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

#### Aneksi 1

#### OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e qerasë për sipefaqen e mbuluar		
a	Siperfaqe e mbuluar m2	
b	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) pa TVSH	
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m2 në (€)	
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) me TVSH	
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)	
e=c+d	Për pagesë në (€)	

Llogaritja e qerasë për sipefaqen e pambuluar		
a	Siperfaqe e pambuluar m2	
b	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) pa TVSH	
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m2 në (€)	
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) me TVSH	
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)	
e=c+d	Për pagesë në (€)	

Gjithsejt qeraja për pagesë në euro (€) \_\_\_\_\_

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhëne me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 17.09.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

#### Aneksi 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

#### DHËNIE ME QERA E OBJEKTIT

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe llogaritja përfundimtare në faturim

**NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Kartës së Shoqërisë të plotësuar dhe ndryshuar, Aksionari i shoqërisë "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, Kati 5, me numër unik identifikues 810093039 ("Shoqëria") ka nxjerr:

**VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË NR. 04/2024**

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet për shumën prej 19,570,000.00 Euro, duke e reduktuar nga vlera e regjistruar prej 32,181,000.00 Euro në 12,611,000.00 Euro. Ky vendim është marrë në përputhje me nenin 147 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që brenda një afati prej 21 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor t'i drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose për të kundërshtuar zvogëlimin e kapitalit. Kërkesat duhet të dërgohen me postë të rregullt në adresën:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, Kati 5

10000 Prishtinë, Kosovë

\*\*\*

**NOTICE OF REDUCTION OF COMPANY CAPITAL****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

In accordance with the requirements of Law No. 06/L-016 on Business Organizations in Kosovo and the amended and restated Charter of the Company, the Shareholder of "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. with headquarters in Pristina, Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, 5th Floor, with unique identification number 810093039 (the "Company") has issued the following:

**DECISION ON REDUCTION OF COMPANY CAPITAL NO. 04/2024**

The company's capital is reduced by the amount of 19,570,000.00 Euros, decreasing from the registered value of 32,181,000.00 Euros to 12,611,000.00 Euros. This decision is made in accordance with Article 147 of the Law on Business Organizations. All creditors of the Company have the right to address the Company with a request for additional security or an objection to the capital reduction within 21 days from the date of publication of this notice in the daily press. Requests should be sent by regular mail to the address:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, 5th Floor

10000 Pristina, Kosovo

\*\*\*

**OBAVEŠTENJE O SMANJENJU KAPITALA DRUŠTVA****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

U skladu sa zahtevima Zakona br. 06/L-016 o privrednim društvima na Kosovu i izmenjenom i dopunjenom Statutom Društva, Akcionar društva "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. sa sedištem u Prištini, Rr. Lidhja e Pejës, br. 177, V sprat, sa jedinstvenim identifikacionim brojem 810093039 ("Društvo") donosi:

**ODLUKU O SMANJENJU KAPITALA DRUŠTVA BR. 04/2024**

Kapital društva se smanjuje za iznos od 19.570.000,00 evra, smanjujući se sa registrovane vrednosti od 32.181.000,00 evra na 12.611.000,00 evra. Ova odluka je doneta u skladu sa članom 147 Zakona o privrednim društvima. Svi poverioci Društva imaju pravo da u roku od 21 dana od dana objavljivanja ovog obaveštenja u dnevnoj štampi obrate Društvu sa zahtevom za dodatno obezbeđenje ili prigovorom na smanjenje kapitala. Zahtevi se šalju poštom na adresu:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, br. 177, V sprat

10000 Priština, Kosovo

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Chocolate Shop" SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811891573 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Chocolate Shop" D.O.O. Prizren, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811891573 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Chocolate Shop" L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 811891573 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Argjent Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të ulët "Fan Noli" Dujakë.
- Mehmet Kelmendi shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik Prishtinë.
- Gani Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Gani Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Danjella Keqani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

Columbus, Georgia, USA  
Since 1909  
0.5L